

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

**Raporti i Audituesit të Pavarur dhe  
Pasqyrat Financiare  
më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021**

## **PËRMBAJTJA**

	<b>Faqe</b>
<b>Raporti i Audituesit të Pavarur</b>	
<b>Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor, 2021</b>	<b>4</b>
<b>Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Pashpërndara më 31 Dhjetor, 2021</b>	<b>5</b>
<b>Pasqyra e Ndryshimeve në Fond më 31 Dhjetor, 2021</b>	<b>6</b>
<b>Pasqyra e Flukseve të mjeteve monetare më 31 Dhjetor, 2021</b>	<b>7</b>
<b>Shënime mbi Pasqyrat Financiare</b>	<b>8 – 31</b>

## RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

### Drejtuar Drejtimit të Albanian Development Guarantee Foundation

#### Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Albanian Development Guarantee Foundation ("Fondacioni"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe fondeve të pashpërndara, pasqyrën e ndryshimeve në fond dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondacionit më datë 31 dhjetor 2021, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset e mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

#### Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Fondacioni në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

#### Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacione të tjera. Të dhënat e tjera përmbajnë informacionin e dhënë në Raportin e Aktivitetit të Performancës, të përgatitur nga drejtimi në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr. 25/2018, datë 19 janar 2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin në të Pasqyrat Financiare dhe Raportin tonë të Auditimit. Raporti i Aktivitetit të Performancës pritet të vihet në dispozicion pas datës së këtij Raporti Auditimi. Opinioni ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin pjesën e të dhenave të tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion që jep siguri në lidhje me këto të dhëna.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë të dhënat e tjera të identifikuar më lart, kur këto të dhëna të jenë të disponueshme dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale në raport me pasqyrat financiare apo njohuritë tona të marra gjatë auditimit, ose përndryshe nëse janë anomali materiale. Pas rishikimit të Raportit të Aktivitetit të Performancës, nëse konstatojmë se ekziston një gabim material në të, nga ne kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen palëve të ngarkuara me qeverisjen.

## **Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Fondacionit për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Fondacionit, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka për qëllim të likujdojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveçse sa më lart. Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Fondacionit.

## **Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare**

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Fondacionit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse nga drejtimi.
- Konkludojmë në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston lidhur me ngjarjet apo kushtet, që mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Fondacionit për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërpreje të aftësisë së Fondacionit për vazhduar në vijimësi.

## Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë që të arrihet një paraqitje e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Fondacionit sa i përket, përveç të tjerash, shtrirjen dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

*Deloitte Audit Albania Shpk*

Deloitte Audit Albania Shpk

Rruga e Kavajës, Ish parku i mallrave, Kompleksi Delijorgji, Godina L, Kati 1, 2 dhe 3  
Tiranë, Shqipëri

Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Enida Cara

Audituese ligjore

Partnere e Angazhimit



DELOITTE ALBANIA SH.P.K.  
NUIS : J62329003N  
Kompleksi Delijorgji, God L, Kati 1, 2, 3 Tiranë

24 Maj, 2022

Tiranë, Shqipëri

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

AKTIVET	Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive materiale	7	2,667,866	2,287,620
Aktive jomateriale	8	357,979	477,306
E drejta e përdorimit të aktiveve	9	18,380,625	15,097,459
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	10	5,071,671,288	4,108,308,860
Depozitë me afat	11	-	61,529,031
Parapagime		-	432,950
<b>Totali i aktiveve afatgjata</b>		<b>5,093,077,759</b>	<b>4,188,133,226</b>
<b>Aktivitet afatshkurtra</b>			
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	10	166,718,337	-
Llogari të arkëtueshme	12	15,715,494	8,466,968
Aktive të tjera afatshkurter	11	124,386,985	61,852,954
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	13	595,569,877	973,449,996
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>		<b>902,390,693</b>	<b>1,043,769,918</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>		<b>5,995,468,452</b>	<b>5,231,903,144</b>
<b>DETYRIME DHE KAPITALI</b>			
<b>Kapitali</b>			
Fondi		4,946,233,332	4,113,448,116
Shpenzime të akumuluar		104,063,233	(33,074,160)
Të ardhura neto për vitin		73,649,562	137,137,393
<b>Totali i kapitalit</b>		<b>5,123,946,126</b>	<b>4,217,511,349</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Të ardhura të shtyra	14	734,676,604	911,839,811
Detyrimi i qirasë	15	14,774,479	13,079,973
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>		<b>749,402,476</b>	<b>924,919,784</b>
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Të ardhura të shtyra	14	7,881,731	6,979,496
Detyrimi i qirasë	15	3,438,133	2,388,962
Provigjone për garanci	22	108,992,462	79,018,551
Detyrime të tjera	16	1,758,917	1,085,002
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>		<b>122,119,849</b>	<b>89,472,011</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>5,995,468,452</b>	<b>5,231,903,144</b>

Këto pasqyra financiare të Fondacionit më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 u aprovuan nga Drejtimi i "Albanian Development Guarantee Foundation" më datë 24 Maj 2022 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Z. Bajram Korsita  
Drejtor Ekzekutiv

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Znj. Besiana Lika  
Menaxhere e financës dhe riskut

Besiana Lika



**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Pasqyra e të Ardhurave dhe Fondeve të Pashpërndara 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i përgjithshëm	17	34,218,679	22,133,146
Te ardhura nga grantet	18	143,216	189,051
Të ardhura të tjera financiare	19	190,340,623	146,090,471
<b>Totali i të ardhurave operative</b>		<b>224,702,518</b>	<b>168,412,668</b>
Shpenzime personeli	20	(15,326,356)	(13,605,456)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	7, 8, 9	(4,446,238)	(3,150,950)
Shpenzime të tjera operative	21	(23,215,729)	(14,248,223)
Shpenzimi për provigjone për garancitë financiare	22	(29,973,911)	(20,197,597)
Shpenzimi për provigjone për instrumentat financiarë	10	(14,099,597)	(17,153,904)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(87,061,830)</b>	<b>(68,356,130)</b>
<b>Humbje operative</b>		<b>137,640,687</b>	<b>100,056,538</b>
Shpenzime financiare		(566,213)	(504,961)
Humbja neto nga kursi i këmbimit	23	(63,424,912)	37,585,816
<b>Humbja neto nga kursi i këmbimit</b>		<b>(63,991,125)</b>	<b>37,080,855</b>
<b>Të ardhura neto</b>		<b>73,649,562</b>	<b>137,137,393</b>
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
<b>Të ardhura të tjera të vitit</b>		<b>73,649,562</b>	<b>137,137,393</b>

Pasqyra e të ardhurave dhe fondeve të pashpërndara duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Pasqyra e Ndryshimeve në Fond më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

	Fondi	(Shpenzime të akumuluarra)/Fonde të pashpërndara	Totali
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	<b>4,113,448,116</b>	<b>(33,074,159)</b>	<b>4,080,373,957</b>
Kontribut nga themeluesi	-	-	-
Te ardhurat neto për vitin	-	137,137,393	137,137,393
Të ardhura gjithëpërfshirëse per vitin	-	-	-
<b>Të ardhurat totale gjithëpërfshirëse për vitin</b>	<b>-</b>	<b>137,137,393</b>	<b>137,137,393</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>4,113,448,116</b>	<b>104,063,233</b>	<b>4,217,511,349</b>
Kontribut nga themeluesi	832,785,216	-	832,785,216
Te ardhurat neto për vitin	-	73,649,562	73,649,562
Të ardhura gjithëpërfshirëse per vitin	-	-	-
<b>Totali i të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse per vitin</b>	<b>-</b>	<b>73,649,562</b>	<b>-</b>
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2021</b>	<b>4,946,233,332</b>	<b>177,712,796</b>	<b>5,123,946,127</b>

Pasqyra e ndryshimeve në fond duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiar



**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Pasqyra e flukseve monetare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
<b>Flukset e mjeteve monetare nga aktiviteti operativ</b>			
E ardhura neto për vitin		73,649,562	137,137,393
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	8,9	4,446,238	3,150,950
Zhvlerësimi i garancive financiare	10,22	44,073,508	37,351,502
Diferenca nga kursi i këmbimit		3,247,235	(16,028)
Shpenzime interesi		566,213	504,961
Të ardhura nga interesi		(192,872,083)	(150,967,833)
<b>Humbja operative përpara ndryshimeve në kapitalin punues</b>		<b>(66,889,327)</b>	<b>27,160,945</b>
<i>Ndryshimet në Kapitalin Punues:</i>			
(Rritje)/Rënie në llogaritë e arkëtueshme		(7,248,526)	(2,291,820)
Rritje në të ardhurat e shtyra		8,003,714	7,072,487
Ulje/(Rritje) në parapagime		432,950	86,465
Rritje/ulje në detyrime të tjera		673,916	(121,859)
Interes i paguar		7,211,016	(2,063,871)
Interes i arkëtuar		170,733,831	131,297,154
<b>Fluksi monetar gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet operative</b>		<b>112,917,574</b>	<b>161,139,501</b>
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti i investimit</b>			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		(941,389)	(505,068)
Investime në bono thesari		-	-
Investime në obligacione		(1,326,970,000)	(1,061,000,000)
Investime në depozita		(483,183,824)	(579,530,000)
Të ardhurat nga afati i depozitave me afat		518,680,006	915,304,613
Të ardhurat nga maturimi i bonove të thesarit		200,000,000	227,000,000
<b>Fluksi monetar përdorur në aktivitetin e investimit</b>		<b>(1,092,415,207)</b>	<b>(498,730,455)</b>
<b>Fluksi monetar nga aktiviteti i financimit</b>			
Grante të marra		652,104,000	836,368,687
Ripagimi i qirasë		(4,871,471)	(2,815,779)
Kontribut nga themeluesi		832,785,216	-
Kapitalizim i grantit		(836,368,687)	-
<b>Fluksi monetar neto nga aktiviteti i financimit (Rënie)/Rritje neto e mjeteve monetare dhe ekuivalente</b>		<b>643,649,058</b>	<b>833,822,804</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar</b>		<b>516,274,170</b>	<b>20,026,292</b>
Efekti i kursit të këmbimit në mjetet monetare		(3,247,235)	16,028
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në 31 dhjetor</b>	12.1	<b>177,178,359</b>	<b>516,274,170</b>

Pasqyra e Flukseve të mjeteve monetare duhet lexuar së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 31, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

## **ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)*

### **HYRJE**

Albanian Development Guarantee Foundation ("Fondacioni" ose "ADGF"), i njohur më parë si Fondacioni Rural Credit Guarantee ("RCGF"), është një organizatë jo-qeveritare jo-fitimprurëse, e themeluar nga GFA Consulting Group GmbH, një Fondacion i vendosur në Gjermani, si implementuese e fondit të grantit. Fondacioni është i regjistruar me numër regjistrimi L52004452B, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës më 8 korrik 2015 dhe ndryshimi i emrit të fondacionit (nga "RCGF" në "ADGF") u aprovua nga gjykata më 6 dhjetor 2021. Ndryshimi i emrit erdhi në kuadër të zgjerimit të fushës së mbulimit për aktivitetet e garantuara për të qenë në përputhje me misionin dhe vizionin e fondacionit.

Albanian Development Guarantee Foundation u themelua në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi Nr.7850 datë 29 qershor 1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe me Ligjin Nr.8788 datë 5 qershor 2001 "Për Organizatat Jo- Fitimprurëse".

Qëllimi kryesor i Fondacionit është të inkurajojë bankat dhe institucionet financiare jo-bankare që të ofrojnë shërbime financiare për mikrobizneset, bizneset e vogla dhe bizneset e mesme në sektorë të ndryshëm të ekonomisë mbi një bazë të qëndrueshme për të mundësuar rritjen e tyre, për të rritur konkurrencën dhe për të krijuar më shumë vende pune.

Fondacioni bashkëpunon me banka dhe institucione financiare jo-bankare për të ofruar garanci të pjesshme për kreditë për mikrobizneset, bizneset e vogla dhe të mesme për të zgjeruar teknologjinë e tyre financiare të kreditimit, duke zhvilluar produkte dhe procedura të veçanta agrare.

Niveli më i lartë i menaxhimit është bordi i drejtorëve i përbërë si në vijim:

John P. Khoury - Kryetar i Bordit

Bahrije Dibra - Anëtare e Bordit; dhe

Lauresha Grezda - Anëtare e Bordit

Përfaqësuesi i Autorizuar i Fondacionit është Drejtori Ekzekutiv, Z. Bajram Korsita.

Më 31 dhjetor 2021, Fondacioni kishte 5 punonjës me kohë të plotë (31 dhjetor 2020: 4 punonjës me kohë të plotë dhe 1 punonjës me kohë të pjesshme).

## **1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **1.1 Baza e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në monedhën shqiptare Lek (LEK), që është edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Fondacionit.

### **2.2 Tepricë krahasuese**

Disa teprica krahasuese në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shënimet e tjera përkatëse në pasqyrat financiare riklasifikohen ose rivlerësohen si rezultat i ndryshimeve në klasifikim ose për të paraqitur një rezultat më të mirë.

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Aplikimi i standardeve të reja dhe të rishikuara

#### a) Standarde dhe Interpretime efektive për vitin aktual

Standardet e reja të mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet e publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit, janë efektive për periudhën aktuale:

- **Ndryshimet në SNRF 9 "Instrumentet Financiarë", SNK 39 "Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja", SNRF 7 "Instrumentet Financiarë: Shënimet Shpjeguese", SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" dhe SNRF 16 "Qiratë"- Reforma e Normës së Interesit Bazë – Faza 2** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2021),
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"**- Konçesionet e Qirasë në lidhje me Covid-19 (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 qershorit 2020. Lejohet zbatimi më i mëparshëm),
- **Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"** – Zgjatja e Përrjashtimit të Përkohshëm nga Zbatimi i SNRF 9 (data e skadencës për përrjashtimin e përkohshëm nga SNRF 9 u zgjat në periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janar 2023).
- Ndikimi i zbatimit fillestar të Koncesioneve të Qirasë në lidhje me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 – **Ndryshimet në SNRF 16**

Zbatimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të veçanta të Fondacionit.

#### b) Standardet dhe Interpretimet në fjalë, nuk janë miratuar ende

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e reja, rishikimet e standardeve ekzistuese dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar por akoma nuk ishin në fuqi:

- **SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit"** (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023),
- **Ndryshimet në SNRF 16 "Qiratë"** – Konçesionet e Qirasë në lidhje me Covid-19 përtej 30 Qershorit 2021 (efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021. Zbatimi më i hershëm lejohet, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e publikimit të ndryshimit.),
- **Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara"** dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Shitja apo Kontributi i Aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorëve të tij, ose sipërmarrjeve të përbashkëta (data e hyrjes në fuqi nuk është caktuar ende),
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare"** – Klasifikimi i detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (data efektive fillon më ose pas 1 janarit 2023),
- **Ndryshimet në SNRF 3 "Kombinimi i Biznesit"** – Referencë e Kuadrit Konceptual (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 – zbatimi më i hershëm është i lejueshëm),

## 2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### 2.3 Aplikimi i standardeve të reja dhe të rishikuara (VAZHDIM)

#### b) Standardet dhe Interpretimet në fjalë, nuk janë miratuar ende (VAZHDIM)

- **Ndryshimet në SNK 16 "Toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje"** - Të ardhura para përdorimit të synuar (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, zbatimi më hershëm është i lejueshëm),
- **Ndryshimet në SNK 37 "Provizione, detyrime të kushtëzuara dhe aktive të kushtëzuara"** - Kontrata me kushte rënduese - Kostoja e përbushjes së një kontrate (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022, zbatimi më i hershëm është i lejueshëm),
- **Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF 2018-2020** – Ndryshimet në SNRF 1 "Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar", SNRF 9 "Instrumentet Financiare", SNRF 16 "Qiratë" dhe SNK 41 "Bujqësia" - Data e hyrjes në fuqi fillon më ose pas 1 janarit 2022, ku zbatimi më i hershëm është i lejueshëm.
- **Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e Pasqyrave Financiare"** dhe Deklarata praktike SNRF 2 Gjykime të materialitetit – Shënime shpjeguese të politikave kontabël – Ndryshimet në SNK 1 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me aplikim më të hershëm të lejuar dhe zbatohen në mënyrë prospektive.
- **Ndryshimet në SNK 8 "Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet"** - Përkufizimi i vlerësimeve kontabël. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2023 për ndryshimet në politikat kontabël dhe në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe, ku aplikimi më i hershëm është i lejuar.
- **Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të Ardhurat"** - Tatimi i Shtyrë në lidhje me Aktivitetet dhe Detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm - në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023, me aplikim më të hershëm të lejuar.

Fondacioni ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde të reja, amendamentet për standardet ekzistuese dhe interpretimin e ri përpara datave të tyre efektive.

## 3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikime në vlerësimet e kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimet janë rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur. Informacioni në lidhje me fushat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më domethënës në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përfshirë në Shënimin 6.

## ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

### 3. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

#### Analiza e ndjeshmërisë

Drejtimi ka konsideruar një skenar standard që përfshin rritjen ose uljen me 10% të probabilitetit të falimentimit (PF) dhe humbjes së pritshme të kredisë (HPK). Analiza e ndjeshmërisë së humbjeve të mundshme të Fondacionit si rezultat i rritjes ose uljes së treguesve të humbjes së kredisë është paraqitur në tabelën më poshtë:

	PF dhe HPK	
	+10%	-10%
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2021 per asetet financiare	5,101,756	(5,101,756)
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2021 per detyrimet financiare	1,879,315	(8,659,559)
PF dhe HPK		
	+10%	-10%
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2020 per asetet financiare	3,691,797	(3,691,797)
Zhvlerësimi më 31 dhjetor, 2020 per detyrimet financiare	7,901,855	(7,901,855)

### 4. PARIMI I VIJUESHMËRISË

Pasqyrat financiare të Fondacionit janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, që supozon se Fondacioni do të vazhdojë të operojë në të ardhmen e parashikueshme, mbështetur në objektivin e lëshimit të garancive financiare.

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë njoftoi një situatë pandemike për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID 19. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet e Qeverisë Shqiptare zbatuan masa të shumta për të kufizuar përhapjen dhe ndikimin e COVID-19, të tilla si ndalimi dhe kufizimi i udhëtimit, karantina e personave të infektuar, si dhe vendosja e kufizimeve në aktivitetin e biznesit, deri në mbylljen e tyre. Masat e mësipërme u lehtësuan gradualisht gjatë viteve 2020 dhe 2021. Këto masa, ndër të tjera, kanë aktivitetet të kufizuar ekonomik në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht në të. Ky ndikim mund të vazhdojë të ketë një ndikim negativ në bizneset, pjesëmarrësit e tregut, bankat, si në Shqipëri ashtu edhe globalisht për një periudhë të panjohur kohore. Sidoqoftë, në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, Fondacioni bazuar në sa më sipër dhe gjithashtu në përputhje me planin financiar të miratuar në vitet në vijim, pret të rrisë aktivitetin e vet operacional dhe ka parashikuar të arrijë një rezultat pozitiv në vitin e ardhshëm dhe të vazhdojë në bazë të parimit të vijueshmërisë.

### 5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

#### 5.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datën e transaksionit. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga konvertimi i transaksioneve të tilla dhe nga përkthimi në kurset e këmbimit të fundvitit të aktiveve dhe pasiveve monetare të shprehura në monedha të huaja, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Kurset e këmbimit të përdorura për konvertimin e zërave të pasqyrës së pozicionit financiar janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Euro/Lek	120.76	123.70

**5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)****5.2 Aktivet afatgjata materiale**

Aktivt afatgjata materiale janë të paraqitura me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar. Fitimi ose humbja neto që del nga nxjerrja jashtë përdorimit ose shitja e nje aktivi afatgjatë material përcaktohet si diferencë midis të ardhurave të shitjes dhe vlerës kontabël të aktivit dhe njihet në pasqyrën e performancës financiare.

Shpenzimet e mëtejshme do të kapitalizohen në qoftë se do të lindin përfitime ekonomike në të ardhmen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë riparimin dhe mirëmbajtjen, njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në momentin kur ndodhin.

Amortizimi fillon kur aktivi është në dispozicion për përdorim. Amortizimi ngarkohet në pasqyrën e fitimit ose humbjes mbi bazën e vlerës së mbetur duke përdorur normat e amortizimit si më poshtë:

<b>Kategoria e aktivit</b>	<b>2021</b>	<b>2020</b>
Mobilje dhe pajisje zyre	20%	20%
Pajisje kompjuterike	25%	25%
Programe kompjuterike	25%	25%

**5.2 Aktivet afatgjata jo-materiale**

Aktivt jo-materiale, të cilat përbëhen tërësisht nga softëare, paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar, nëse ka. Amortizimi paguhet duke përdorur metodën e reduktimit të balancës. Shkalla e amortizimit e përdorur për aktivet jo-materiale është 25%. Metoda e jetës së dobishme dhe e amortizimit rishikohet në fund të çdo viti raportues vjetor, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim që llogaritet mbi një bazë prospektive.

**5.3 Qiratë sipas SNRF 16**

Fondacioni vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira, në fillimet e kontratës. Fondacioni njih një të drejtë të përdorimit të aseteve dhe një pasiv korrespondues të qirasë në lidhje me të gjitha marrëveshjet e qirasë në të cilat është qiramarrësi, përveç qirave afatshkurtra (të përcaktuara si qira me afat qiraje 12 muaj ose më pak) dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Për këto qira, Fondacioni i njih pagesat e qirasë si një shpenzim operativ mbi një bazë lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë, përveç nëse një bazë tjetër sistematike është më përfaqësuese e modelit kohor në të cilin konsumohen përfitimet ekonomike nga aktivet me qira.

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të skontuara duke përdorur normën implicite në qira. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtë, Fondacioni përdor normën e tij në rritje të huamarrjes. Në përgjithësi, Fondacioni përdor normën e tij të huamarrjes si normë zbritjeje.

## ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

### 5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 5.3 Qiratë sipas SNRF 16 (vazhdim)

Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e pasivit të qirasë përmbajnë:

- Pagesat fikse të qirasë (përfshirë pagesat fikse në thelb), minus çdo stimul të qirasë së arkëtueshme;
- Pagesat e ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, fillimisht maten duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit;
- Shuma që pritet të paguhet nga qiramarrësi sipas garancive të vlerës së mbetur;
- Çmimi i ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt se do të ushtrojë opsionet; dhe
- Pagesat e gjobave për përfundimin e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për përfundimin e qirasë.

Detyrimi i qirasë paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

Detyrimi i qirasë më pas matet duke rritur vlerën kontabël për të reflektuar interesin në pasivin e qirasë dhe duke zvogëluar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e bëra të qirasë.

Fondacioni rimat detyrimin e qirasë (dhe bën një rregullim përkatës të të drejtës së përdorimit të aseteve) sa herë që:

- Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar të skontimit.
- Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshimi në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, në këto raste detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar të skontimit (nëse ndryshimi i pagesave të qirasë nuk është për shkak të ndryshimit në një normë interesi luhatëse, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e skontimit).
- Një kontratë qiraje modifikohet dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së modifikuar duke skontuar pagesat e rishikuara të qirasë me përdorimin e një normë të rishikuar të skontimit në fuqi në datën e modifikimit.

E drejta e përdorimit të aseteve përfshin matjen fillestare të pasivit përkatës të qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para ditës së fillimit, minus çdo stimul të marrë nga qiraja dhe çdo kosto fillestare direkte. Më pas ato maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi.

E drejta e përdorimit të aseteve zhvlerësohet gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të të drejtës së përdorimit të aktiveve. Nëse një qira transferon pronësinë e aktivitetit themelor ose kostoja e të drejtës së përdorimit të aseteve pasqyron që Fondacioni pret të ushtrojë një mundësi blerjeje, aktiviteti i lidhur me të drejtën e përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivitetit themelor. Amortizimi fillon në datën e fillimit të qirasë.

E drejta e përdorimit të aseteve paraqitet si një vijë e veçantë në pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar.

Fondacioni zbaton SNK 36 për të përcaktuar nëse e drejta e përdorimit të aseteve është zhvlerësuar dhe llogaritet për çdo humbje të identifikuar të zhvlerësimit siç përshkruhet në politikën "Aktivet afatgjata materiale".

## ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

### 5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 5.4 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare

##### (i) Njohja

Fondacioni fillimisht njihet të arkëtueshmet financiare, depozitat dhe llogaritë investuese në datën në të cilën ato krijohen. Blerjet dhe shitjet normale të një aktivi financiar janë njohur në datën e tregtimit në të cilën Fondacioni zotohet të blejë ose të shesë aktivin. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Fondacioni bëhet palë me kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv ose detyrim financiar është matur fillimisht me vlerën e drejtë, plus kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen apo emetimin e tij për ato aktive ose detyrime financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.

##### (ii) Klasifikimi

Shih politikat kontabël 3.5; 3.6; 3.8 dhe 3.9.

##### (iii) Çregjistrimi

Fondacioni çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose kur transferon aktivin financiar në një transaksion ku të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivit financiar janë transferuar, ose në ato raste kur Fondacioni as nuk ruan dhe as nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar dhe nuk mban kontroll mbi aktivin financiar.

Ndonjë interes mbi aktivet financiare të transferuara që plotësojnë kushtet për mosnjohje, i cili është krijuar apo përfituar nga Fondacioni, njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Në çregjistrimin e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës kontabël të aktivit (ose vlerës kontabël që i takon pjesës së transferuar të aktivit) dhe shumës së arkëtuar dhe çdo fitim apo humbje e akumuluar që është njohur në të ardhurat gjithëpërfshirëse do të njihet në pasqyrën e fitim ose humbjes.

Fondacioni merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por në të njëjtën kohë ruan të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara ose një pjesë të tyre. Nëse ruhen të gjitha rreziqet dhe përfitimet, atëherë aktivet e transferuara vazhdojnë të njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve ku ruhen thuajse të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin për shembull transaksionet e riblerjeve.

Në transaksionet ku Fondacioni as nuk ruan dhe as nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar, Fondacioni vazhdon të njohë aktivin, në masën e përfshirjes së vet në vazhdim, që përcaktohet nga masa në të cilën është ekspozuar ndaj ndryshimit të vlerës së aktivit të transferuar.

Fondacioni çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale përfundojnë, anulohen ose i mbaron afati.



(Shumat në Lek)

## 5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

### 5.4 Aktivet financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

#### (iv) *Netimi*

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe vlera e tyre neto të paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Fondacioni ka një të drejtë ligjore për të netuar shumat dhe synon ose ti shlyejë mbi një bazë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten mbi baza neto vetëm kur lejohen nga SNRF-të, ose për fitime dhe humbje nga një grup transaksionesh të ngjashme si në rastin e aktiviteteve tregtare të Fondacionit.

#### (v) *Matja e kostos së amortizuar*

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe shumës së maturimit, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

#### (vi) *Matja e vlerës së drejtë*

Vlera e drejtë është çmimi me të cilin aktivi mund të shitet, ose një pasiv të transferohet, ndërmjet pjesëmarrësve në treg në një transaksion të zakonshëm, në datën e matjes në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Fondacioni ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur është e mundur, Fondacioni mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Një treg shikohet si aktiv nëqoftëse transaksioni për një aktiv ose detyrim ndodh me një shpeshtësi dhe volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion për çmimet në vazhdimësi. Në qoftë se për një instrument financiar nuk ka çmim në treg aktiv, Fondacioni përdor teknika të vlerësimit për vlerën e drejtë që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave jo të vëzhgueshme. Teknikat e zgjedhura të vlerësimit përfshijnë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg, marrin parasysh në përcaktimin e çmimit në një transaksion.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të instrumentit financiar në njohjen fillestare, është çmimi i transaksionit, p. sh. vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë.

Nëse Fondacioni përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, dhe vlera e drejtë nuk është evidentuar as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të njëjtë, as bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyruara, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të rregulluar për të ulur diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në pasqyrën e fitim ose humbjes në baza të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut ose transaksioni është i mbyllur.

Nëqoftëse një aktiv apo detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim oferte dhe çmim kërkese, atëherë Fondacioni mat aktivet, pozicionet e gjata në çmimin e ofruar dhe detyrimet, pozicionet e shkurtra me një çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më pak se shumata e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë në të cilën mund të kërkohet shumata për t'u paguar.

#### (vii) *Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit*

Aktivitetet që janë subjekt i amortizimit rishikohen për zhvlerësim sa herë që ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave tregojnë se vlera kontabël mund të mos jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet për shumën me të cilën vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Vlera e rikuperueshme është më e larta midis vlerës së drejtë të një aktivi minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Nuk ka pasur asnjë zhvlerësim të aktiveve jo financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

## **ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

### **5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

#### **5.5 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë arkën dhe llogaritë bankare me Fondacionin.

#### **5.6 Investime të mbajtura për të mbledhur flukset monetare kontraktuale**

Investimet financiare maten fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e letrave me vlerë të investimit që nuk kanë vlerë të drejtë në pasqyrën e fitimit ose humbjes, duke shtuar kostot shtesë direkte të transaksionit. Mjetet financiare të Fondacionit klasifikohen si të mbajtura për të mbledhur, sepse duke marrë parasysh modelin e tyre të biznesit ato mbahen me qëllim grumbullimin e flukseve monetare kontraktuale; dhe kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar japin në data të caktuara flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

#### **5.7 Balanca e Fondit**

Balanca e Fondit konsiston në vlerën e drejtë të vlerave monetare të kontribuara nga themeluesi.

#### **5.8 Të ardhura të shtyra**

Të ardhurat e shtyra përfaqësojnë grantet e marra nga GFA, Ministria e Bujqësisë dhe Kfw. Fillimisht ato njihen si të ardhura të shtyra.

Granti njihet si e ardhur gjatë periudhës në përputhje me kostot përkatëse të cilat janë të destinuara të kompensojnë, mbi baza sistematike.

#### **5.9 Llogari të pagueshme dhe të tjera**

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### **5.10 Kontrata për garancitë financiare**

Kontratat e garancisë financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që ndodh sepse një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesat kur është e nevojshme, në përputhje me afatin e një instrumenti borxhi. Garancitë e tilla financiare u jepen bankave dhe NFBI-ve në emër të bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin agrar.

Kontratat e garancisë financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe më pas maten me vlerën më të lartë nga:

- shuma e kompensimit për humbje (llogaritur në përputhje me kërkesat e SNRF 9 për modelin e pritshëm të humbjes së kredisë); dhe
- shuma më e vogël e njohur më parë, kur është e përshtatshme, shuma kumulative e të ardhurave të njohura në përputhje me parimet e SNRF 15

## **5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)**

### **5.11 Provigjonet për garancitë**

Fondacioni siguron garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në bazë të % për ndarjen e riskut dhe me maksimum 500,000 Euro ose ekuivalente me 60,885,000 Lek dhe garanton huamarrjet komerciale të institucioneve mikrofinanciare nga bankat vendase nën garanci të veçanta. Provigjoni për kontratat e garancisë financiare njihet kur një debitor i caktuar nuk kryen pagesat kur duhet, në përputhje me afatin e një instrumenti borxhi.

Fondacioni vlerëson në bazë të parashikimit humbjen e pritur të kredisë që lidhet me ekspozimin që rrjedh nga kontratat e garancisë financiare. Fondacioni, për humbje të tilla njih një shumë të lejuar të humbjeve, në cdo datë raportimi.

### **5.12 Të ardhura nga grantet**

Një grant njihet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ka një siguri të arsyeshme që do të merret dhe Fondacioni do të permbushë kushtet bashkangjitur grantit. Grantet të cilat kompensojnë Fondacionin për shpenzimet e njohura, njihen si e ardhur në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë sistematike në të njëjtën periudhë që njihen shpenzimet. Grantet që kompensojnë Fondacionin për kostot e një aktivi njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes si e ardhur në bazë sistematike mbi jetën e dobishme të një aktivi.

Drejtimi vlerëson se grantet e marra kanë lidhje me shpenzimet operative të Fondacionit dhe nuk mbulojnë provigjonin dhe efektin e kursit të këmbimit.

### **5.13 Të ardhurat nga tarifa e disbursimit të huave**

Tarifa e disbursimit të huave është njohur si e ardhur në bazë proporcionale kohore gjatë periudhës së angazhimit. Përrjashtim mund të ketë vetëm në rastin e një marrëveshje specifike të huadhënies.

### **5.14 Të ardhura nga interesat e huave të garantuara**

E ardhura nga interesi i garancisë së huasë njihet në bazë të proporcionit kohor që merr parasysh metodën e normës efektive të interesit.

### **5.15 Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas shfrytëzimit të shërbimit.

### **5.16 Përfitimet e punonjësve**

Detyrimet për kontributet e përcaktuara të planeve të pensionit njihen si shpenzime në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse kur ato ndodhin. Fondacioni paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat sigurojnë përfitime kur punonjësit arrijnë moshën e pensionit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin e një niveli minimal pensioni sipas një plani të përcaktuar të kontributeve.

Në 12 janar 2018, Fondacioni ka nënshkruar një marrëveshje me Sigal Uniqa Group Austria lidhur me një anëtarësim në fondin vullnetar të pensionit, ku Fondacioni do të kontribuojë së bashku me punonjësit e tij. Në 1 nëntor 2019, Fondacioni nënshkroi një kontratë me Sigal Uniqa Group Austri për sigurimin shëndetësor privat për punonjësit, ku Fondacioni paguan një prim vjetor sigurimi. Polica e sigurimit shëndetësor privat rimbursion shpenzimet mjekësore nën një listë të veçantë të përfitimeve dhe një kufi maksimal vjetor me zonën e mbulimit: spitale private në Shqipëri dhe Europë.

## ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

### 5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

#### 5.17 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Albanian Development Guarantee Foundation është themeluar si një organizatë jo-fitimprurëse dhe për këtë arsye, sipas rregullores për organizatat jo-fitimprurëse në Shqipëri, është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin. Fondacioni është gjithashtu i përjashtuar nga tatimi në burim mbi të ardhurat dhe bankat nuk e mbajnë këtë tatim nga Fondacioni.

### 6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

#### 6.1 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë, është rreziku i humbjes financiare së Fondacionit, nëse një klient ose një palë tjetër në lidhje me një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale, dhe vjen kryesisht nga depozitat bankare të Fondacionit, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre.

Rreziku i kredisë për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre konsiderohet i papërfillshëm, pasi kundërpasitë janë Fondacione me reputacion.

Ekspozimi maksimal i Fondacionit ndaj rrezikut të kredisë, përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar, e paraqitur në tabelën më poshtë (shumat paraqiten në Lek):

<i>Klasat e aktiveve financiare – vlerat e mbetura</i>	<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	177,178,359	516,274,170
Depozita afatshkurtra -BKT	358,391,518	457,175,826
Depozita afatshkurtra -Fibank	35,000,000	-
Depozita afatshkurtra –Union Bank	124,386,985	123,381,985
Depozita afatshkurtra – Credins Bank	25,000,000	-
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	5,238,389,626	4,108,308,860
<b><u>Vlera Kontabël</u></b>	<b><u>5,958,346,488</u></b>	<b><u>5,205,140,841</u></b>

Tabela më poshtë paraqet ekspozimin e riskut e kredisë ndaj kundërpasitë dhe falimentimit apo zhvlerësimeve të lidhura, nëse ka:

<b>Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale</b>	<b>Qeveria Shqiptare</b>	<b>Totali</b>
<b><i>Më 31 dhjetor 2021</i></b>		
As me vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo me vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	5,284,468,292	5,284,468,292
Të zhvlerësuara	(46,078,667)	(46,078,667)
<b>Total</b>	<b>5,238,389,626</b>	<b>5,238,389,626</b>
<b><i>Më 31 dhjetor 2020</i></b>		
As me vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo me vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	4,144,008,420	4,144,008,420
Të zhvlerësuara	(35,699,560)	(35,699,560)
<b>Total</b>	<b>4,108,308,860</b>	<b>4,108,308,860</b>

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**

**6.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre	Banka të Nivelit të Dytë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2021</i>		
As me vonesë dhe as të zhvlerësuara	177,178,359	177,178,359
Jo me vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	422,216,889	422,216,889
Zhvlerësim	(3,825,371)	(3,825,371)
<b>Total</b>	<b>595,569,877</b>	<b>595,569,877</b>

<i>Më 31 dhjetor 2020</i>		
As me vonesë dhe as të zhvlerësuara	516,274,170	516,274,170
Jo me vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	-	-
<b>Total</b>	<b>516,274,170</b>	<b>516,274,170</b>

Depozitat me afat	Banka të Nivelit të Dytë	Totali
<i>Më 31 dhjetor 2021</i>		
As me vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo me vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	125,500,511	125,500,511
Zhvlerësim	(1,113,526)	(1,113,526)
<b>Total</b>	<b>124,386,985</b>	<b>124,386,985</b>

<i>Më 31 dhjetor 2020</i>		
As në vonesë dhe as të zhvlerësuara	-	-
Jo në vonesë, por të zhvlerësuara sipas kërkesave të SNRF 9	581,776,218	581,776,218
Zhvlerësim	(1,218,407)	(1,218,407)
<b>Total</b>	<b>580,557,811</b>	<b>580,557,811</b>

Fondacioni përdor vlerësimet e kredive të publikuara në agjensitë ndërkombëtare të vlerësimit të kredisë për përlogaritjen e probabiliteteve të mospagimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare të detajuar si më poshtë:

Vlerësimi sipas Moody's për 2021	Institucioni	Probabiliteti i mospagimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	1.93%
B+	Banka e Shqipërisë	1.93%
Nuk është publikuar vlerësim	Credins Bank	-
Nuk është publikuar vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	-

Vlerësimi sipas Moody's për 2020	Institucioni	Probabiliteti i mospagimit
B+	Qeveria e Shqipërisë	1.93%
B+	Banka e Shqipërisë	1.93%
Nuk është publikuar vlerësim	Credins Bank	-
Nuk është publikuar vlerësim	Banka Kombëtare Tregtare	-

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****6.2 Rreziku i likuiditetit**

Manaxhimi i kujdesshëm i rrezikut të likuiditetit, nënkupton mbajtjen e mjeteve monetare të mjaftueshme dhe disponueshmërinë e fondeve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Fondacionit në momentin që ato duhet të shlyhen.

Tabelat e mëposhtme paraqesin maturimet e mbetura kontraktuale të detyrimeve financiare të Fondacionit më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020.

**Më 31 dhjetor 2021**

	<b>Vlera kontabël neto</b>	<b>3 muaj ose më pak</b>	<b>3-12 muaj</b>	<b>1-10 vite</b>
<b>Aktive Financiare</b>				
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	595,569,877	595,569,877	-	-
Depozita afatshkurtra	124,386,985	124,386,985	-	-
Llogari të arkëtueshme	15,715,494	15,715,494	-	-
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	5,238,389,626	59,839,731	106,878,606	5,071,671,288
	<b>5,974,061,981</b>	<b>795,512,087</b>	<b>106,878,606</b>	<b>5,071,671,288</b>
<b>Detyrime Financiare</b>				
Detyrime të tjera	1,758,917	1,758,917		
Detyrime të qirasë	18,212,613	-	3,438,133	14,774,479
Detyrime kontigjente	2,791,932,142		2,791,932,142	
	<b>2,811,903,671</b>	<b>1,758,917</b>	<b>2,795,370,275</b>	<b>14,774,479</b>
<b>Ekspozimi Neto</b>	<b>3,162,158,310</b>	<b>793,753,170</b>	<b>(2,688,491,669)</b>	<b>5,056,896,809</b>

Kërkesat e likuiditetit për të mbështetur thirrjet nën garancitë financiare janë dukshëm më pak se sasia e angazhimit të shpalosur në analizën e mësipërme të maturimit, sepse Fondacioni zakonisht nuk pret që pala e tretë të tërheq fonde në bazë të marrëveshjes. Shuma totale e detyrimeve kontraktuale të zotimeve për të përdorur garancitë financiare të përfshira në tabelën e e mësipërme të maturimit nga 3 deri në 12 muaj nuk paraqet domosdoshmërisht kërkesat e ardhshme të parave të gatshme, pasi shumë nga këto angazhime do të skadojnë ose përfundojnë pa u financuar.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**6. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**
**6.2 Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**
**Më 31 dhjetor 2020**

	Vlera kontabël neto	3 muaj ose më pak	3-12 muaj	1-10 vite
<b>Aktive Financiare</b>				
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	516,274,170	516,274,170	-	-
Depozita afatshkurtra	457,175,826	457,175,826	-	-
Llogari të arkëtueshme	8,466,967	8,466,968		
Investime të mbajtura për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale	4,108,308,860	-	200,712,165	3,907,596,695
	<b>5,090,225,823</b>	<b>981,916,963</b>	<b>200,712,165</b>	<b>3,907,596,695</b>
<b>Detyrime Financiare</b>				
Detyrime të tjera	1,085,001	1,085,001		
Detyrime të qirasë	15,468,935	-	2,394,756	13,074,179
Detyrime kontigjente	1,896,022,643		1,896,022,643	
	<b>1,912,576,579</b>	<b>1,085,001</b>	<b>1,898,417,399</b>	<b>13,074,179</b>
	<b>3,177,649,244</b>	<b>980,831,962</b>	<b>(1,697,705,234)</b>	<b>3,894,522,516</b>
<b>Ekspozimi Neto</b>				

**7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Mobilje zyre dhe pajisje	Pajisje Kompjuterike	Përmirësime në dhënie e qirasë	Totali
<b>Kosto</b>				
Më 31 dhjetor 2019	1,247,033	1,405,438	706,911	3,359,382
Shtesa	110,568	394,500	-	505,068
Më 31 dhjetor 2020	<b>1,357,601</b>	<b>1,799,938</b>	<b>706,911</b>	<b>3,864,450</b>
Shtesa	35,000	126,000	780,389	941,389
Më 31 dhjetor 2021	<b>1,392,601</b>	<b>1,925,938</b>	<b>1,487,300</b>	<b>4,805,839</b>
<b>Zhvlerësim i akumuluar</b>				
Më 31 dhjetor 2019	(448,757)	(504,870)	-	(953,627)
Zhvlerësim për vitin	(179,867)	(295,738)	(147,597)	(623,202)
Më 31 dhjetor 2020	<b>(628,624)</b>	<b>(800,608)</b>	<b>(147,597)</b>	<b>(1,576,829)</b>
Zhvlerësim për vitin	(147,060)	(249,918)	(164,164)	(561,142)
Më 31 dhjetor 2021	<b>(775,684)</b>	<b>(1,050,526)</b>	<b>(311,761)</b>	<b>(2,137,971)</b>
<b>Vlera kontabël neto</b>				
Më 31 dhjetor 2020	728,977	999,330	559,314	2,287,621
Më 31 dhjetor 2021	<b>616,917</b>	<b>875,412</b>	<b>1,175,539</b>	<b>2,667,868</b>

Aktivet afatgjata materiale nuk janë vendosur si kolateral ndaj palëve të treta më 31 dhjetor 2021 dhe 2020.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**8. AKTIVE JO MATERIALE**

Aktivet jo materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	<b>Programe kompjuterike</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>		
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,616,200</b>	<b>1,616,200</b>
Shtesa	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,616,200</b>	<b>1,616,200</b>
Shtesa	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>1,616,200</b>	<b>1,616,200</b>
<i>Amortizimi i akumuluar</i>		
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(979,792)</b>	<b>(979,792)</b>
Amortizimi për vitin	(159,102)	(159,102)
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(1,138,894)</b>	<b>(1,138,894)</b>
Amortizimi për vitin	(119,327)	(119,327)
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>(1,258,221)</b>	<b>(1,258,221)</b>
<i>Vlera e mbetur</i>		
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>477,306</b>	<b>477,306</b>
<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>357,979</b>	<b>357,979</b>

**9. E DREJTA E PËRDORIMIT TË ASETVEVE**

E drejta e përdorimit të asetveve më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020 është detajuar si më poshtë:

	<b>E drejta e përdorimit</b>	<b>Totali</b>
<i>Kosto</i>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>19,081,510</b>	<b>19,081,510</b>
Shtesat	-	-
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>19,081,510</b>	<b>19,081,510</b>
Shtesat	7,048,935	7,048,935
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>26,130,446</b>	<b>26,130,446</b>
<i>Zhvlerësimi i akumuluar</i>		
<b>Më 1 janar 2020</b>	<b>(1,467,809)</b>	<b>(1,467,809)</b>
Shpenzimi e vitit	(2,516,243)	(2,516,243)
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>(3,984,052)</b>	<b>(3,984,052)</b>
Shpenzimi e vitit	(3,765,769)	(3,765,769)
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>(7,749,820)</b>	<b>(7,749,820)</b>
<i>Vlera Neto</i>		
<b>Më 31 Dhjetor 2020</b>	<b>15,097,459</b>	<b>15,097,459</b>
<b>Më 31 Dhjetor 2021</b>	<b>18,380,625</b>	<b>18,380,625</b>



**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**10. INVESTIME TË MBAJTURA PËR MBLEDHJEN E FLUKSEVE MONETARE KONTRAKTUALE**
**Obligacione**

Investimet në obligacione më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Obligacione	2,252,700,000	1,548,500,000
Obligacione- Eurobonde	2,958,620,000	2,535,850,000
Zbritje – Obligacione	(5,706,476)	(6,911,978)
Prim - Obligacione	1,922,109	2,206,537
Prim - Eurobonde	9,219,124	11,771,244
Zbritje Eurobonde	(3,005,369)	-
Interes i akumuluar - Obligacione	41,931,704	24,907,540
Interes i akumuluar - Eurobonde	28,787,200	27,685,077
<b>Totali</b>	<b>5,284,468,292</b>	<b>4,144,008,420</b>
Zbritje për zhvlerësim	(46,078,667)	(35,699,560)
<b>Vlera kontabël totale</b>	<b>5,238,389,626</b>	<b>4,108,308,860</b>

Gjatë vitit 2021 Fondacioni bleu investime të reja në Obligacione në Lek dhe Euro. Obligacionet e reja të Thesarit kanë kupon fiks 5.38% dhe 5% që do të maturohen në 10 vjet; kupon fiks 4.25% që do të maturohet në 7 vjet, kupon fiks 2.8% që do të maturohet në 3 vjet dhe kupon fiks 2.65% që do të maturohet në 2 vjet. Dy investime të tjera të reja të obligacioneve janë bërë në Euro (Eurobonde), me vlerë nominale prej 3,000,000 EUR dhe 1,000,000 EUR, të dyja me kupon fiks 3.5% që do të maturohet në 10 vjet.

	Obligacione	Obligacione- Eurobonde
<b>Teprica celëse më 1 janar</b>	1,548,500,000	2,535,850,000
Të maturuara gjatë periudhës	(200,000,000)	-
Investimet gjatë periudhës	904,200,000	483,840,000
Ndryshimi në vlerë nga kursi i këmbimit	-	(61,070,000)
<b>Teprica mbyllëse më 31 dhjetor</b>	<b>2,252,700,000</b>	<b>2,958,620,000</b>

Obligacionet e reja të Thesarit të blera me afat maturimi 3 vjet janë blerë me zbritje me normë interesi 2.95%, që është më e lartë se norma e kuponit 2.8%. Gjithashtu, Eurobonot me afat maturimi 10 vjet janë blerë një zbritje me normë interesi përkatësisht 3.59% për vlerën nominale prej 3,000,000 EUR, dhe 3.53% për vlerën nominale prej 1,000,000 EUR, për të cilat norma fikse e kuponit është 3.5%.

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Letra me vlerë të thesarit në lekë	2,290,847,337	1,568,702,099
Letrat me vlerë të thesarit në Euro	2,993,620,955	2,575,306,320
Zbritje për zhvlerësim	(46,078,667)	(35,699,560)
<b>Total</b>	<b>5,238,389,626</b>	<b>4,108,308,859</b>

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**Obligacione thesari (vazhdim)**

	<b>2021</b>			
	<b>Etapat sipas Humbjes së Pritshme për Asetet Financiare</b>			
	<b>Etapa 1</b>	<b>Etapa 2</b>	<b>Etapa 3</b>	<b>Totali</b>
Investime	5,284,468,292	-	-	5,284,468,292
<b>Shuma bruto</b>	<b>5,284,468,292</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,284,468,292</b>
Provigjone	(46,078,667)	-	-	(46,078,667)
<b>Shuma neto</b>	<b>5,238,389,626</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,238,389,626</b>

  

	<b>2020</b>			
	<b>Etapat sipas Humbjes së Pritshme për Asetet Financiare</b>			
	<b>Etapa 1</b>	<b>Etapa 2</b>	<b>Etapa 3</b>	<b>Totali</b>
Investime	4,144,008,419	-	-	4,144,008,419
<b>Shuma bruto</b>	<b>4,144,008,419</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,144,008,419</b>
Provigjone	(35,699,560)	-	-	(35,699,560)
<b>Shuma neto</b>	<b>4,108,308,859</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>4,108,308,859</b>

**11. DEPOZITAT ME AFAT**

Depozitat me afat më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	<b>Më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>
Depozita me afat Union	121,840,000	60,990,000
Intersi i perlloritur - depozita	3,660,511	1,003,578
Zhvleresimi i depozitave	(1,113,526)	(140,624)
<b>Totali i aktualeve</b>	<b>124,386,985</b>	<b>61,852,954</b>
Depozita me afat Union	-	60,850,000
Interesi i perlloritur - depozita	-	1,241,590
Zhvleresimi i depozitave	-	(562,559)
<b>Totali i jo-aktualeve</b>	<b>-</b>	<b>61,529,031</b>
<b>Totali</b>	<b>124,386,985</b>	<b>123,381,985</b>

Në 31 dhjetor 2021, Fondacioni ka dy depozita në Union Bank: një depozitë me afat 12 muaj për shumën prej 60,990,000 Lek, me 2.22% normë interesi dhe me datë maturimi më 23 mars 2022 dhe një depozitë me afat 25 muaj për shumën prej 60,850,000 Lek me 2.25% normë interesi dhe me datë maturimi më 4 mars 2022.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)***12. LLOGARITË E ARKËTUESHME**

Llogaritë e arkëtueshme më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
<b>Afatshkurtra</b>		
Të arkëtueshme nga Mikrofinancat	3,643,257	2,197,297
Të arkëtueshme nga Bankat	11,610,970	5,869,631
Parapagime	461,267	400,040
<b>Nëntotali</b>	<b>15,715,494</b>	<b>8,466,968</b>
<b>Afatgjata</b>		
Parapagime	-	432,950
<b>Nëntotali</b>	-	<b>432,950</b>
<b>Totali</b>	<b>15,715,494</b>	<b>8,889,918</b>

Llogaritë e arkëtueshme në 31 dhjetor 2021 përfaqësojnë shumat e papaguara nga Bankat dhe Institucionet Mikro – Financiare lidhur me interesat dhe tarifrat paraprake për tre mujorin e katërt të vitit.

**13. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTE TË TYRE****13.1 Mjete monetare në arkë dhe në bankë**

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
Mjete monetare në bankë në Lek	43,798,584	71,963,929
Mjete monetare në bankë në Euro	133,379,611	444,302,861
Mjete monetare në arkë	165	7,380
<b>Totali mjete monetare në arkë dhe bankë</b>	<b>177,178,359</b>	<b>516,274,170</b>

Më 31 dhjetor, 2021 paraja në bankë përfshin llogaritë rrjedhëse të mbajtura në BKT, bankën Credins, Union Bank, Fibank, OTP Bank dhe Raiffeisen Bank.

**13.2 Depozita afatshkurtra**

Depozitat afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Depozita me afat	422,193,818	457,690,000
Interesi i përlllogaritur	23,071	1,050
<b>Totali</b>	<b>422,216,889</b>	<b>457,691,050</b>
Zhvlerësim	(3,825,371)	(515,224)
<b>Vlera kontabël totale</b>	<b>418,391,518</b>	<b>457,175,826</b>

ADGF hyri në dy marrëveshje të tjera për depozita afatshkurtra me BKT me detajet e mëposhtme:

- 50 000 000 LEK, depozitë 1 mujore me normë interesi 0.3% dhe datë maturimi në 24 janar 2022.
- 2 000 000 EUR, depozitë 1 mujore me normë interesi 0,05% dhe datë maturimi në 10 janar 2022.
- 582,242 EUR, depozitë 1 mujore me normë interesi 0,05% dhe datë maturimi në 14 janar 2022.

Fondacioni gjithashtu hyri në marrëveshje të depozitave afatshkurtra me Credins Bank për 1 muaj depozitë me vlerë 25,000,000 Lek, me normë interesi 0.3% dhe datë maturimi në 10 janar 2022 dhe me OTP Bank për 1 muaj depozitë me vlerë 35.000.000 Lek, me normë interesi 0.35% dhe datë maturimi në 10 janar 2022.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**14. TË ARDHURA TË SHTYRA**

Të ardhurat e shtyra përfshijnë dy rrjedha si më poshtë:

Nga grantet - Një grant njihet në pasqyrën e pozicionit financiar fillimisht si e ardhur e shtyrë kur ekziston një siguri e arsyeshme që do të merret dhe se Fondacioni do të përmbushë kushtet e bashkangjitura. Më 9 dhjetor 2021, Fondacioni mori një grant nga KfW për një shumë ekuivalente me 653,724,000 lekë.

Nga tarifatat paraprake - Tarifa paraprake është një tarifë e njëhershme e llogaritur në shumën e garantuar të huasë dhe merret kur kredia disbursohet.

Më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 të ardhurat e shtyra janë detajuar si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
<b>Pjesa afatshkurtër</b>		
Tarifa e disbursimit	7,738,515	6,790,445
Grante nga GFA	139,245	183,756
Grante nga dega GFA-së në Shqipëri	3,971	5,295
	<b>7,881,731</b>	<b>6,979,496</b>
<b>Pjesa afatgjatë</b>		
Tarifa e disbursimit	19,450,485	12,300,231
Grante nga GFA	299,696	394,430
Grante nga dega GFA-së në Shqipëri	8,538	11,185
Grante afatgjata nga Ministria e Bujqësisë	62,765,278	62,765,278
Grante nga Kfw	652,104,000	836,368,687
	<b>734,627,997</b>	<b>911,839,811</b>
<b>Totali</b>	<b>742,558,334</b>	<b>918,819,307</b>

**15. DETYRIMI PËR QIRANË**

Termat dhe kushtet e detyrimeve të papaguara të qirasë më 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

	Monedha	Norma e huamarrjes	Viti i maturimit	Pagesa minimale mujore e qirasë	
				Në Monedhë	Në Lek ('000)
Detyrimi i qirasë	EUR	3.00%	2019-2026	2,700	326,052

Detyrimet e qirasë	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
Analizuar si:		
Jo-aktuale	3,438,133	2,388,962
Aktuale	14,774,479	13,079,973
	<b>18,212,613</b>	<b>15,468,935</b>

Më poshtë janë paraqitur flukset monetare të paskontuara për shlyerjet e detyrimeve të qirasë sipas vitit të maturimit:

Analiza e maturitetit	31 Dhjetor 2021	31 Dhjetor 2020
- Më pak se një vit	3,438,133	2,388,962
- Midis një dhe dy vitesh	3,537,400	2,461,625
- Midis dy dhe tre vitesh	3,639,553	2,536,498
- Midis tre dhe katër vitesh	3,744,674	2,613,648
- Më shumë se pesë vite	3,852,852	5,468,203
<b>Detyrimi për qira financiare</b>	<b>18,212,613</b>	<b>15,468,935</b>

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)***16. DETYRIME TË TJERA**

Detyrimet e tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Tatim mbi të ardhurat personale	169,286	134,277
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	159,884	95,379
Kreditorë / furnitorë lokalë	-	(1,497)
Tatim në burim	14,372	707
Interes i përlogaritur	1,415,375	856,136
<b>Totali</b>	<b>1,758,917</b>	<b>1,085,002</b>

**17. TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I PËRGJITHSHËM**

Të ardhurat nga aktiviteti i përgjithshëm përfaqësojnë të ardhura nga tarifat e disbursimit dhe të interesit, të cilat fitohen nga aktiviteti kryesor i Fondacionit - duke i ofruar garanci për Institucionet Financiare Partnere. Llogaria përbëhet nga:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesi nga bankat	17,250,138	7,180,556
Të ardhura nga interesi nga Mikrofinancat	7,207,063	8,555,295
Të ardhura nga tarifa e disbursimit nga Mikrofinancat	4,092,080	3,451,988
Të ardhura nga tarifa e disbursimit nga bankat	5,669,398	2,945,307
<b>Totali</b>	<b>34,218,679</b>	<b>22,133,146</b>

Fondacioni fiton nga Institucionet e Mikro Financimit 0.75% interesa cdo vit mbi mesataren ditore të balancës së mbetur. E ardhura e interesit nga bankat llogaritet si përqindje (specifikuar në kontratë) mbi mesataren e balancës së mbetur të tremujorit.

Tarifa e disbursimit është një tarifë e vetme e përlogaritur mbi vlerën e huasë së garantuar dhe merret kur huaja disbursohet. Tarifat e disbursimit regjistrohen fillimisht si të ardhura të shtyra dhe më pas njihen si të ardhura ose shpenzime përgjatë maturimit të huasë së garantuar.

**18. TË ARDHURA NGA DONACIONET**

Të ardhurat nga donacionet përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga donacioni – Zhvlerësimi i aktiveve të dhuruara nga GFA	143,216	189,051
<b>Totali</b>	<b>143,216</b>	<b>189,051</b>

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)***19. TË ARDHURA TË TJERA FINANCIARE**

Të ardhurat e tjera financiare përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Të ardhura nga interesat e letrave me vlerë	184,883,470	143,652,807
Të ardhura nga interesat e depozitave	2,839,411	2,437,664
Të ardhura të tjera nga rimbursimi i tatimit në burim	2,617,742	-
<b>Total</b>	<b>190,340,623</b>	<b>146,090,471</b>

Të ardhura të tjera financiare përbëhen kryesisht nga të ardhura prej interesave të investimeve në obligacione thesari, depozita bankare dhe të ardhura të tjera nga rimbursimi i tatimit në burim. Të ardhurat e tjera nga rimbursimi i tatimit në burim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 përfaqësojnë rimbursimin e shumës të mbajtur në të kaluarën nga OTP Bank, Credins Bank dhe Union Bank për të ardhurat e krijuara nga investimet në tituj qeveritarë dhe depozita. Rimbursimi u bë në muajt qershor dhe dhjetor 2021. Bazuar në vendimin përfundimtar të lëshuar më 25.05.2021 nga Drejtoria e Apelit Tatimor, Fondacioni është i përjashtuar nga mbajtja e tatimit në burim dhe bankat nuk duhet ta mbajnë tatimin për fondacionin.

**20. SHPENZIME PERSONELI**

Shpenzimet e personelit përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Paga bruto	13,615,179	12,232,562
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,043,585	792,284
Kontributet e fondit të pensionit	667,592	580,610
<b>Totali</b>	<b>15,326,356</b>	<b>13,605,456</b>

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)***21. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE**

Shpenzime të tjera operative përbëhen si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
Pagesë për rimbursim të klientëve	8,988,681	349,842
Tarifat bankare për ruajtjen e investimeve	5,298,700	339,160
Tatim i mbajtur në burim	5,037,814	9,441,380
Audit	1,370,882	1,401,942
Mirëmbajtja dhe furnizimet e zyrës	1,038,591	929,245
Sigurime shëndetsore	438,856	371,039
Shpenzimet e sigurimeve	295,511	308,400
Shpenzime të tjera	167,791	83,785
Tarifat bankare	165,688	67,865
Posta dhe komunikimi	150,063	160,201
Shërbime Komunale	100,773	60,877
Konsulencë tatimore	73,938	434,351
Shpenzimet e trajnimit për personelin	73,440	165,854
Taksat vendore	15,000	15,000
Konsulencë ligjore	-	119,282
<b>Totali</b>	<b>23,215,729</b>	<b>14,248,223</b>

Në 31 dhjetor 2021, pagesa për rimbursimin e klientëve përfaqëson pagesat e kredive për 11 klientë të BKT dhe 2 klientë të Credins Bank me më shumë se 180 ditë vonesë, duke mbuluar 50% të vlerës së pashlyer të kredisë sipas marrëveshjes kontraktuale me bankat, në shumën prej 8,988,681 LEK (2020: 349,842 LEK).

**22. PROVIGJONE PËR GARANCI FINANCIARE DHE INVESTIME**

Lëvizja në shpenzimet e provigjionit për garancitë ndaj bankave dhe institucioneve mikro-financiare është si më poshtë:

	<b>2021</b>	<b>2020</b>
<b>Më 1 janar</b>	<b>79,018,551</b>	<b>58,820,953</b>
Garancitë financiare të humbura	(5,942,745)	(27,361)
Rimarrje provigjioni për vitin	(11,018,816)	(17,479,729)
Shpenzim provigjioni për vitin	46,935,472	37,704,687
<b>Shpenzim provigjioni për vitin, neto</b>	<b>29,973,911</b>	<b>20,197,597</b>
<b>Më 31 Dhjetor</b>	<b>108,992,462</b>	<b>79,018,550</b>

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, ka një rritje të shpenzimeve të provigjioneve për garancitë financiare, e cila lidhet drejtpërdrejt me shumën e provigjionit të llogaritur nga bankat partnere dhe përqindjen e kredive jo-performuese gjatë tre viteve të fundit nga MFI-të.

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**22. PROVIJONE PËR GARANCI FINANCIARE DHE INVESTIME (VAZHDIM)**

<i>Provigjone per Investimet</i>	2021	2020
<b>Më 1 janar</b>	<b>35,699,560</b>	<b>15,414,973</b>
Rimarrje provigjoni për investime	-	(55,231)
Shpenzim provigjoni për investime	10,379,107	20,339,818
<b>Shpenzim provigjoni për vitin, neto</b>	<b>10,379,107</b>	<b>20,284,587</b>
<b>Në fund të vitit, 31 dhjetor</b>	<b>46,078,667</b>	<b>35,699,560</b>
<i>Provigjone per depozitat me afat</i>	2021	2020
<b>Më 1 janar</b>	<b>1,218,407</b>	<b>4,349,090</b>
Rimarrje provigjoni për depozitat me afat	-	(4,349,090)
Shpenzim provigjoni për depozitat me afat	3,720,491	1,218,407
<b>Shpenzim provigjoni për vitin, neto</b>	<b>3,720,491</b>	<b>(3,130,683)</b>
<b>Në fund të vitit, 31 dhjetor</b>	<b>4,938,898</b>	<b>1,218,407</b>
<b>Shpenzimi total i provigjoni të periudhes, neto</b>	<b>14,099,597</b>	<b>17,153,904</b>
<b>Totali në fund të periudhes, neto</b>	<b>51,017,564</b>	<b>36,917,967</b>

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, ka një rritje të shpenzimeve të provigjoneve për investime, e cila lidhet drejtpërdrejt me shumën e zhvlerësimit të llogaritur për investimin e fondeve në obligacione thesari dhe depozita.

**23. FITIM/(HUMBJE) NETO NGA KURSI I KËMBIMIT**

Llogaria përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi nga kursi i këmbimit valuator	5,726,993	56,273,215
Humbja nga kursi i këmbimit valuator	(69,151,905)	(18,687,399)
<b>Fitimi/(Humbje) nga përkthimet në valutë, neto</b>	<b>(63,424,912)</b>	<b>37,585,816</b>



**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

(Shumat në Lek)

**24. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË KUSHTËZUARA**

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 Fondacioni nuk ka pretendime ligjore kundër tij në rrjedhën normale të biznesit.

Detyrimet e kushtëzuara më 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2021		Më 31 Dhjetor 2020	
	Vlera e mbetur e garantuar	Vlera e disbursuar e garantuar	Vlera e mbetur e garantuar	Vlera e disbursuar e garantuar
<b>Detyrimet e kushtëzuara</b>				
Garanci ndaj NOAs	538,123,413	916,300,000	461,448,810	552,700,000
Garanci ndaj FedInvest-it	181,505,000	375,800,000	256,665,000	375,800,000
Garanci ndaj Unifin	-	-	-	-
Garanci ndaj Fondit Besa	473,730,400	832,625,800	417,939,000	582,625,800
Garanci për Crimson Finance Fund Albania	23,527,449	24,152,000	-	-
Garanci për Agro & Fondi Social	-	-	-	-
Garanci ndaj klientëve të Credins Bank	191,413,818	398,116,210	153,424,488	308,348,407
Garanci ndaj klientëve të BKT	39,989,798	188,940,240	67,471,149	175,614,849
Garanci ndaj klientëve të Union Bank	430,782,078	551,613,180	144,526,207	185,811,860
Garanci ndaj klientëve të Fibank	65,594,708	78,249,700	24,376,086	26,461,950
Garanci ndaj klientëve të OTP Bank	836,730,709	1,036,641,306	370,171,903	421,755,370
<b>Totali</b>	<b>2,781,397,372</b>	<b>4,402,438,436</b>	<b>1,896,022,643</b>	<b>2,610,458,716</b>

Fondacioni ofron garanci për klientët nëpërmjet institucioneve bankare në bazë të ndarjes së riskut dhe me një limit maksimal prej 500,000 Euro dhe garanton huamarrjet komerciale të institucioneve mikrofinancuese nga bankat lokale nën garanci të veçanta.

Vlera e mbetur e garantuar lidhet me shumën e garantuar të gjendjes së pashlyer të kredisë së garantuar nga Fondacioni. Vlera e disbursuar e garantuar lidhet me shumën e garantuar të kredisë së disbursuar, e cila është nga 50% në 70% të shumës totale të disbursuar për institucionet bankare, bazuar në kushtet e parashikuara në Marrëveshjet e Partneritetit, dhe nga 70% në 100% të shumës të disbursuara për institucionet mikrofinancuese bazuar në kushtet e parashikuara në Memorandumin e Mirëkuptimit.

**25. TRANSAKSIONE ME PALËT E LIDHURA**

Një palë është e lidhur me një entitet nëse, direkt ose indirekt përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike, pala ka një interes në njësinë ekonomike që i jep ndikim të rëndësishëm mbi entitet, pala ka kontroll të përbashkët mbi njësinë ekonomike, pala është një ortak ose pala është një anëtar i personelit drejtues kryesor të njësisë ekonomike ose mëmës së tij.

Transaksionet me palët e lidhura përbëjnë:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Grantet afatgjata nga KFW	652,104,000	836,368,687
Grantet afatgjata nga GFA	299,696	394,430
Grantet afatgjata nga dega e GFA-së në Shqipëri	8,538	11,185

**ALBANIAN DEVELOPMENT GUARANTEE FOUNDATION**

Shënime për pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021

*(Shumat në Lek)*

<b>Totali</b>	<b>652,412,234</b>	<b>836,774,302</b>
	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
<b><i>Të ardhura</i></b>		
Të ardhura nga grantet – Zhvlerësimi i aseteve	143,216	189,051
<b>Totali</b>	<b>143,216</b>	<b>189,051</b>
<b>Kompensimi i Manaxhimit</b>		
	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</b>
<b><i>Të ardhura</i></b>		
Kompensimi i Manaxhimit	5,509,188	5,297,292
<b>Totali</b>	<b>5,509,188</b>	<b>5,297,292</b>

**26. NGJARJE PAS DATES SË RAPORTIMIT FINANCIAR**

Konflikti i vazhdueshëm ushtarak në Ukrainë dhe sanksionet përkatëse të synuara kundër Federatës Ruse mund të kenë ndikim në ekonominë evropiane dhe globale. Njësia ekonomike nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rosisë ose Bjellorusisë. Megjithatë, ndikimi në situatën e përgjithshme ekonomike mund të kërkojë rishikime të supozimeve dhe vlerësimeve të caktuara. Kjo mund të çojë në rregullime materiale të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të caktuara brenda vitit të ardhshëm financiar. Në këtë fazë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me besueshmëri ndikimin pasi ngjarjet po zhvillohen dita ditës. Ndikimi afatgjatë mund të ndikojë gjithashtu në vëllimet e tregtimit, flukset monetare dhe përfitimin. Megjithatë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, Fondacioni vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën kur ato janë të maturuara dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë bazën e vazhdimësisë së përgatitjes.

Manaxhimi i Fondacionit nuk është në dijeni të ndonjë ngjarjeje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime ose dhënie informacionesh shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.